

**AKT NORMATIV**  
**Nr. 3, datë 6.7.2026**

**PËR FINANCIMIN E PJESSHËM TË ORGANIZIMIT TË NJË AKTIVITETI**  
**KULTUROR-TURISTIK ME PËRMASA NDËRKOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Financimin e pjesshëm të organizimit dhe të mbarëvajtjes së një aktiviteti kulturor-turistik, me ndikim në promovimin e turizmit dhe të imazhit të Republikës së Shqipërisë, koncerti i artistit të njohur ndërkombëtar, Kanye West (YE), që do të zhvillohet në Tiranë, në datën 11 korrik 2026, në masën 400 000 000 (katërqind milionë) lekë.

**Neni 2**

Shuma në masën 400 000 000 (katërqind milionë) lekë, sipas nenit 1, të këtij akti normativ, pakësohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit dhe i shtohet Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit në zërin 604 “Transferta të brendshme”, të programit 04760 “Zhvillimi i turizmit”.

**Neni 3**

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit autorizohet të nënshkruajë marrëveshjen përkatëse me kompaninë organizatore të eventit, me qëllim disbursimin e fondit të parashikuar në nenin 1, të këtij akti normativ.

**Neni 4**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**